

# Buxhetimi i OZhQ-ve në institucionet e nivelit lokal





Autor: Donikë Beqiri

Kontribuoi: Fiona Bakija

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Shkurt, 2023

Dizajni: KUKU Creative



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

---

## Përmbajtja

Hyrje.....	5
Ku qëndron Kosova në raport me zbatimin e Agjendës 2030 .....	7
Buxheti për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm .....	9
Modalitete të buxhetimit të OZhQ-ve në nivel lokal.....	13
Përfundime dhe Rekomandime .....	16
Shtojca A – Integrimi i Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm në planet buxhetore komunale .....	19
Shtojca B – Analiza e buxhetimit të OZhQ-ve .....	23

## **Lista e shkurtesave**

AKK – Asociacioni i Komunave të Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

KB – Kombet e Bashkuara

KZhQ – Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MSA – Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit

OZhQ – Objektivet për Zhvillim të Qëndrueshëm

PZhK – Plani Zhvillimor Komunal

## Hyrje

Agjenda 2030 mbetet ende në hije dhe jo e prioritizuar nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë, për këtë arsye ka ngecje të mëdha të zbatimit dhe avancimit të saj. Dihet se për të avancuar këtë agjendë kërkohet angazhim nga palë të ndryshme të interesit, megjithatë angazhimi, puna madje edhe promovimi për këtë agjendë ende mbetet i vakët. Përndryshe objektiva konkrete për përmbushjen e agjendës 2030 do të duhej të vendoseshin fillimisht në nivel qendror e pastaj edhe në nivel lokal, në mënyrë që të ketë hapa konkret drejtë progresit dhe të kërkohet llogaridhënie për një agjendë absolutisht të nevojshme për t'u aplikuar në vitin 2022. Por natyrisht për këtë avancim nevojitet përkushtim i madh nga institucionet e nivelit qendror dhe në të njëjtën kohë edhe nga ato të nivelit lokal. Patjetër që për një zbatim të mirëfilltë të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve do të duhej bashkëpunim në të gjitha nivelet, duke përfshirë çdoherë edhe akterë të ndryshëm relevantë për të marrë pjesë në procese të hartimit të strategjive si dhe në fazat tjera implementuese në mënyrë që të ketë gjithëpërfshirje dhe të mos lihet anash, asnjë komunitet i caktuar dhe i nevojshëm në mënyrë që të përmbushen objektivat për zhvillim të qëndrueshëm.

Për arsye se Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, dhe nuk është e obliguar të zbatojë dhe raportojë mbi Agjendën 2030 dhe përmbushjen e OZhQ-ve, Kosova tashmë ka filluar, edhe pse me hapa të ngadaltë të përfshihet në zbatimin e kësaj Agjende. Në mënyrë që të ketë rezultate konkrete për një agjendë që ka afat skadence në periudhë 8 vjeçare duke filluar që tani, do të duhej të fillohej puna në mënyrë intensive. Kjo për arsyen se Kosova edhe pse ka filluar punën në këtë drejtim, dhe tashmë janë ndërmarrë disa iniciativa të ndryshme nga Parlamenti, OShC dhe organizata ndërkombëtare, ende mbetet në fazë tepër fillestare në raport me zbatimin e Agjendës 2030. Miratimi i Rezolutës për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe themelimi i Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm në vitin 2018 kanë qenë hapat e parë të ndërmarrë nga niveli qendror për zbatimin e Agjendës 2030.

Në nivelin lokal ka pasur iniciativa të ndërmarra me qëllim të promovimit të Agjendës 2030 dhe vetëdijësimit të zyrtarëve kompetentë si dhe për të vlerësuar gjendjen aktuale të komunave në raport me zbatimin e Agjendës 2030 por edhe për të përmirësuar gjendjen aktuale të implementimit të OZhQ-ve në nivel lokal dhe kombëtar. Sfidë e madhe e implementimit të agjendës 2030 në nivel lokal është padyshim mungesa e të dhënave e cila pamundëson pasqyrimin e gjendjes reale të komunave të caktuara në raport me Agjendën 2030. Poashtu, sfida e dytë e rëndësishme është mungesa e buxhetimit të Agjendës 2030 fillimisht në nivel nacional e pastaj edhe në nivel lokal. Kjo mungesë e buxhetimit tregon edhe mungesë prioritizimi dhe planifikimi të kësaj agjende në cdo nivel qeverisës në

Kosovë. Përfshirja e OZhQ-ve në buxhetim nacional dhe lokal përveç që ndikon në zbatimin dhe evidentimin e zbatimit të saj, gjithashtu mundëson mos-përsëritjen e alokimeve të mjeteve financiare që vijnë nga burime të ndryshme për të njëjtën agjendë, njëkohësisht duke ndikuar kështu në një zbatim koherent të projekteve të buxhetuara në nivele të ndryshme qeverisëse.

Kjo analizë politikash shpërfaq në përgjithësi rëndësinë që luan inkorporimi i OZhQ-ve në planifikimet buxhetore të institucioneve të nivelit qendror dhe të nivelit lokal. Për të prioritetizuar zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve patjetër duhet integruar atë në kornizat buxhetore, e cila në të njëjtën kohë mundëson edhe përafrimin e objektivave të vendit me OZhQ-të. Analiza tregon sipërfaqësisht ku e gjen Kosovën zbatimin i Agjendës 2030 në vitin 2022, si dhe mundësitë e integritit të kësaj kornize në procese dhe planifikime buxhetore të institucioneve të nivelit lokal dhe qendror. Poashtu jep një pasqyrë të shkurtër si mund të inkorporohet buxheti i OZhQ-ve në format aktuale të komunave të Kosovës, duke marrë si shemull Komunën e Drenasit, e cila njihet si pioner për angazhimin për OZhQ në Republikën e Kosovës.

## Ku qëndron Kosova në raport me zbatimin e Agjendës 2030

Agjenda 2030 dhe agjenda të tjera ndërkombëtare pa të cilat nuk është i mundur një integrim i plotë evropian, janë të domosdoshme të prioritizohen në agjendat politike të politik-bërësve. Agjenda 2030 në veçanti kërkon ndërkoordinim dhe bashkëveprim institucional të një sërë akterësh në mënyrë që të fillojë të zbatohet dhe të ketë rezultate të suksesshme. Kjo agjendë kërkon ndërveprim të Qeverisë, të institucioneve tjera të pavarura, OShC-ve dhe sektorit privat në mënyrë që t fillojë të zbatohet në mënyrë të suksesshme. Patjetër që përveç ndërveprimit të institucioneve, mungojnë një sërë hapash fillestar për të buxhetuar dhe filluar me zbatimin e OZhQ-ve.

<sup>1</sup>Meqenëse Kosova nuk është vend anëtar i KB-ve, nuk e ka të obliguar 'zbatimin' e as raportimin për Agjendën 2030. Por duke qenë se kjo agjendë është plan gjithëpërfshirës për të adresuar probleme dhe sfida globale që prekin jo vetëm vendet në zhvillim, por edhe vendet e zhvilluara, ka shtete që kanë filluar të adaptojnë OZhQ-të në strategjitë e tyre, si dhe kanë filluar të zbatojnë këtë agjendë në baza vullnetare. Një ndër këto




Figura 1. Reflektimi i OZhQ-ve në Programin e Qeverisë 2020 – 2023

shtete është edhe Kosova. Republika e Kosovës ka filluar punën drejtë zbatimit të kësaj Agjende, fillimisht në vitin 2016, ku në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021<sup>2</sup> ka integruar edhe planin për zbatimin e OZhQ-ve. Hap tjetër i rëndësishëm dhe themeltar për zbatimin e OZhQ-ve ndodhi në vitin 2018, kur Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e quajtur Rezoluta 06-R-001 dhe në të njëjtën kohë ka themeluar edhe Këshillin për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i cili operon në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe ka përgjegjësinë kryesore për monitorimin e zbatimit të Agjendës 2030. Kjo rezolutë ndër tjerash parasheh edhe raportimin kombëtar të progresit të zbatimit të OZhQ-ve në baza vjetore, megjithatë Kosova ende nuk ka përgatitur dhe dërguar në Asamblen e Përgjithshme të KB-ve një raport të tillë. Duhet të përmendet

<sup>1</sup>Figura e adaptuar nga analiza 'Reflektimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Programin e Qeverisë 2020 – 2023', INDEP, 2020

<sup>2</sup>Zyra e Kryeministrit, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021/PLANI për Zhvillim të Qëndrueshëm, Janar 2016, Prishtinë, qasur për herë të fundit më 29.03, në [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Zhvillim\\_2016-2021\\_Shqip.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf)



padyschim se zbatimi i Agjendës 2030 luan rol kyç edhe në obligimet e Kosovës në raport me bashkësitë ndërkombëtare si Bashkimi Evropian. Kjo për faktin se MSA ka një kapitull të tërë të dedikuar për agjendat evropiane reformuese, dhe edhe pse kjo është agjendë e dalur nga Asambleja e Përgjithshme e KB-ve, është agjendë globale për të cilën janë zotuar 193 vende për zbatimin e saj, ndër tjera edhe vendet anëtare të BE-së.

Përkundër hapave fillestarë të ndërmarra nga institucionet e Republikës së Kosovës, ende ka mungesë të elementeve bazike për zbatimin e Agjendës 2030 në Kosovë. Të dhënat janë problem mjaft i rëndësishëm që luajnë rol kyç në monitorimin e zbatimit të Agjendës 2030 si dhe zbatimin e saj. Mungesa e të dhënave është problem në nivel kombëtar në Kosovë, dhe në nivel lokal, meqenëse institucionet qendrore nuk kanë mekanizma apo instrumente me të cilët mund të bashkëpunojnë për shkëmbimin e të dhënave me institucione lokale dhe të tjera të cilat është e domosdoshme të kenë qasje në një platformë me të dhëna të përditësuara. Pikë e rëndësishme e mungesës së zbatimit të Agjendës 2030 është edhe mungesa e monitorimit të duhur të zbatimit të saj, e cila vjen prej mungesës së mekanizmit institucional për monitorim. Edhe pse Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm<sup>3</sup> është mekanizmi i vetëm institucional i përgjegjshëm për zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve, është e domosdoshme të rishqyrtohet strukturimi i këtij mekanizmi të vetëm aktualisht në nivele institucionale. Kjo për faktin se Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm është grup joformal i përbërë nga deputetët e Parlamentit, Sekretariati i Kuvendit dhe partnerë tjerë të jashtëm. Në shumë vende të cilat janë zotuar për përmbushjen e OZhQ-ve, mekanizma të tillë për koordinimin e përmbushjes së OZhQ-ve, nuk bien tërësisht nën nivelin legjislativ si në rastin e Kosovës, por zakonisht janë të vendosura nën drejtimin e pushtetit ekzekutiv, ku edhe rëndësia dhe përgjegjësia ndaj avancimit të Agjendës 2030 është më e madhe si dhe përkushtimi është patjetër i një niveli më të lartë. Sipas udhëzuesit të UNDP-së për Mekanizmat Institucional dhe Koordinues, shtetet që kanë të vendosura trupat koordinues për zhvillim të qëndrueshëm nën drejtimin e Zyrës së Kryeministrit, kanë arritur që të koordinojnë dhe zbatojnë OZhQ-të në mënyrë më efektive<sup>4</sup>. Në rastin e Kosovës, në mënyrë që Këshilli të jetë i suksesshëm në punën e tij duhet patjetër të krijojë grupe tematike të punës të cilët përbëhen nga ekspertë teknikë dhe të cilët do të jenë të angazhuar në objektiva të ndryshme dhe detyra specifike që duhet të realizohen përkrah agjendës politike të draftuar nga KZhQ-së. Ky patjetër, është hap urgjent që duhet ndërmarrë në nivele institucionale qendrore, në mënyrë që të fillohet të strukturohet puna në drejtimin e duhur për sa i përket përmbushjes së OZhQ-ve.

---

<sup>4</sup> UNDP; The Institutional and Coordination Mechanisms guidance note; 2017, i qasshëm në [https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/2478Institutional\\_Coordination\\_Mechanisms\\_GuidanceNote.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/2478Institutional_Coordination_Mechanisms_GuidanceNote.pdf)

Gjithsesi pa koordinimin e autoriteteve qendrore me ato lokale, pa hartimin e politikave të caktuara në nivel qendror dhe lokal, si dhe pa përfshirjen edhe të palëve të tjera si OJQ-të ndërkombëtare dhe lokale, sektori privat, akademia e të tjerë nuk mund të përmbushen 169 qëllimet e OZhQ-ve. Ngritja e kapaciteteve e zyrtarëve komunalë për të punuar për përmbushjen e OZhQ-ve mbetet gjithashtu kusht i rëndësishëm në nivel lokal për avancimin e Agjendës 2030. Për këtë arsye duhet punuar të gjithë në koherencë me njëri tjetrin në mënyrë që të jemi në gjendje të adresojmë sfidat globale që duhet trajtuar për të pasur zhvillim të qëndrueshëm. Agjenda 2030 është platformë pune e kompletuar, përmes së cilës akterë të ndryshëm mund të punojnë bashkarisht për të përmbushur qëllimet dhe njëkohësisht për të ngritur standardin e jetesës dhe për të avancuar drejtë një të ardhme më të mirë.

## **Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Buxhetimi komunal është procesi i shpërndarjes së burimeve financiare për programe, shërbime dhe iniciativa të ndryshme brenda një komune. Tradicionalisht, ky proces është fokusuar në balancimin e buxhetit dhe plotësimin e nevojave imediate të komunitetit. Megjithatë, në vitet e fundit, ka pasur një ndërgjegjësim në rritje për nevojën për të harmonizuar buxhetin komunal me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs).

Integrimi i OZHQ-ve në buxhetimin komunal kërkon një përqasje buxhetimi të bazuar në rezultate. Kjo qasje fokusohet në arritjen e rezultateve dhe objektivave specifike, në vend që thjesht të shpërndahet buxhet për programe dhe shërbime të ndryshme. Duke vendosur objektiva të qarta dhe duke monitoruar progresin, qytetet dhe komunat mund të sigurojnë që burimet e tyre financiare të përdoren në mënyrë efektive dhe të arrihen rezultatet e dëshiruara.

Një mënyrë tjetër për të integruar OZHQ-të në buxhetimin komunal është përdorimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje. Kjo qasje përfshin angazhimin e banorëve, grupeve të komunitetit dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e buxhetimit. Duke u dhënë qytetarëve një zë në mënyrën se si ndahen burimet financiare, komunat mund të sigurojnë që buxheti i tyre të pasqyrojë nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Përfshirja e OZHQ-ve në buxhetimin komunal nënkupton gjithashtu marrjen në konsideratë të ndikimit afatgjatë të vendimeve buxhetore. Është e rëndësishme të merret në konsideratë se si vendimet buxhetore sot do të ndikojnë në të ardhmen, psh. investimet në infrastrukturë, energjinë e ripërtrishme dhe mbrojtjen sociale që përputhen me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Së fundi, është e rëndësishme të kemi një mekanizëm të qartë për të vlerësuar progresin e OZHQ-ve dhe për t'i raportuar rezultatet tek niveli qendror, tek qytetarët dhe palët e tjera të interesuara. Kjo do t'i ndihmojë komunat të identifikojnë fushat e progresit dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Për të përmbledhur, buxhetimi komunal është një mjet i rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe krijimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë qytetarët. Duke i përfshirë OZHQ-të në procesin e buxhetimit, qytetet dhe komunat mund të sigurojnë që burimet e tyre financiare të përdoren në mënyrë efektive dhe të arrijnë rezultatet e dëshiruara. Kjo mund të bëhet përmes përdorimit të buxhetimit të bazuar në rezultate, buxhetimit me pjesëmarrje dhe duke marrë parasysh ndikimin afatgjatë. Vlerësimi dhe raportimi i progresit në OZHQ-të është gjithashtu një hap i rëndësishëm për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien.

Duke pasur parasysh aspiratat dhe obligimet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar të punojë dhe në përgjithësi rëndësinë e Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, tashmë është bërë e domosdoshme që kjo agjendë të priorizohet në tavolinat e vendim-marrësve. Në mënyrë që Agjenda 2030 të trajtohet me seriozitetin e nevojshëm, duhet të fillohet edhe buxhetimi për përmbushjen e OZHQ-ve. Patjetër që për tu bërë kjo, duhet një ndryshim rrënjësor dhe azhurnim i mënyrës së të buxhetuarit në nivel qendror dhe lokal, dhe duhet bërë ndryshe nga ç'është bërë deri tani.

Në përgjithësi buxhetimi për OZHQ-të është bërë tashmë një standard i radhës përmes të cilit shtetet po tentojnë të adaptojnë Objektivet për Zhvillim të Qëndrueshëm në planet dhe strategjitë afatgjate. Mirëpo buxhetimi për OZHQ-të nuk nënkupton domosdoshmërisht alokimin e mjeteve financiare të reja për të përmbushur këto objektiva, por ka të bëjë më tepër me ristrukturimin e buxheteve dhe shpenzimeve aktuale dhe gjetjen e mënyrave të reja të përdorimit të mjeteve financiare në dispozicion për të përmbushur OZHQ-të. Megjithatë, për të përafruar programet buxhetore me OZHQ-të dhe Agjendën 2030 dhe për cfarëdo lloj planifikimi buxhetor në këtë aspekt, duhet të konsultohen organet adekuate në fushën e financave dhe buxhetimit si Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave. Por përderisa plani i përgjithshëm i buxheteve të ndara nga organet kompetente, ende mund të mos ndahet në mënyrë eksplicite për OZHQ-të, ministritë përkatëse dhe përgjegjëse për objektiva të caktuara mund të rialokojnë mjetet financiare për të kontribuar në objektivat me të cilat përkohësi planet strategjike të tyre. Rast i tillë është edhe Hungaria, ku edhe pse Qeveria nuk ka planifikuar buxhet të ndarë për përmbushjen e OZHQ-ve, ministri të caktuara në

qeverisjen e vitit 2019<sup>5</sup> kanë përafuar dhe kanë tentuar të strukturojnë punën e tyre në drejtim të përmbushjes së OZhQ-ve. Rast i suksesshëm në Evropë janë gjithashtu Finlanda dhe Islanda, të cilat janë të vetmet shtet të cilat kanë integruar në mënyrë gjithëpërfshirëse buxhetimin për OZhQ-të.<sup>6</sup>

Megjithëse inkorporimi i OZhQ-ve në procese dhe planifikime buxhetore mbetet ende sfidë më vete, vendet evropiane kanë filluar të adaptojnë këtë trend dhe kjo duhet ndjekur edhe nga Kosova. Përveç përpilimit të strategjive të reja afatgjate për zbatimin dhe përmbushjen e OZhQ-ve, është e nevojshme të rishikohen planet vjetore ekzistuese të buxhetimit dhe të rishqyrtohen mundësi për të integruar OZhQ-të në to. Kjo duhet të bëhet në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe të gjenden mënyra koordinimi mes këtyre dy niveleve. Për ta bërë këtë, apriori duhet analizuar dhe cakuar cilat objektiva dhe indikatorë përshtaten në nivel nacional dhe të vendosen afate kohore për përmbushjen e tyre, gjithmonë duke ju përshtatur mundësive për t'u realizuar në kontekst vendi. Duke i përkthyer OZhQ-të në objektiva të qarta nacionale, si dhe duke i integruar ato në planet e veprimit duke i adaptuar në kontekst vendi dhe duke vendosur kështu afate kohore për realizimin e tyre, mund të bëhet plani i buxhetimit për OZhQ-të më pak i sfidueshëm.

Gjithsesi, integrimi i OZhQ-ve në politika kombëtare si dhe projektimi i buxhetimit në këtë drejtim, mund të sjellë përfitime të ndryshme për vendin. Fillimisht, duke reduktuar mundësinë për ndryshime të shpeshta të objektivave politike, si pasojë e ndërrimit të shpeshtë të Qeverive, meqenëse fatkeqësisht në Kosovë, qeveritë e kaluara nuk kanë pasur jetëgjatësi më shumë se 3 vite, dhe ndërrimi i shpeshtë i qeverive ka pamundësuar dhe penguar qëndrueshmërinë e planeve të veprimit

#### SDG DASHBOARDS AND TRENDS



Note: The full title of Goal 12 "Responsible Consumption and Production" is "End human activities that contribute to climate change and promote sustainable lifestyles".

Figura 2. Diagrami i përmbushjes së OZhQ-ve në Finlandë

<sup>5</sup> Mulholland Eric & Berger Gerald; Budgeting for the SDGs in Europe: Experiences, Challenges and Needs, Institute for Managing Sustainability, April 2019, i qasshëm në

[https://www.esdn.eu/fileadmin/ESDN\\_Reports/ESDN\\_Quarterly\\_Report\\_52\\_Final.pdf](https://www.esdn.eu/fileadmin/ESDN_Reports/ESDN_Quarterly_Report_52_Final.pdf)

<sup>6</sup> Ibid

dhe strategjive, duke qenë se qeveri të ndryshme kanë prioritizuar çështje të ndryshme. Kështu adaptimi i një kornize të tillë globale lë hapsirën e nevojshme për të punuar në këtë drejtim nga secili akter i mundshëm, duke synuar kështu trajtimin e sfidave të cilat ndodhen në kontekst global, dhe të cilat mund të përkthehen dhe përvetësohen lehtëzi në kontekst të vendit. Meqenëse Kosova është vend në tranzicion, dhe sfidat që trajtohen përmes Agjendës 2030 janë tema të nevojshme për t'u trajtuar në mënyrë të thukët në Kosovë, integrimi dhe buxhetimi i tyre vetëm sa do të lehtësonte punën e vendim-marrësve, duke bërë më të lehtë vendosjen e objektivave, synimeve, përkitazi me sfidat lokale, zbatimin si dhe monitorimin e tyre përmes kësaj platforme. NJë strukturim i tillë i punës nga ana e vendim-marrësve do të rriste dhe llogaridhënien kundrejt qytetarëve, si dhe do të përfronte objektivat e zhvillimit me ato të vendeve më të zhvilluara, duke mundësuar kështu edhe aktraksion të shtuar për investime kapitale dhe përfrimin me agjendat e donatorëve ndërkombëtarë.

Përveç përfitimeve të shumta që Kosova mund të përfitonte si vend, krahas zhvillimit të vendit në një mënyrë të qëndrueshme, inkorporimi i OZhQ-ve në buxhetim mundëson edhe evidentimin e zbatimit të saj. Për më tepër, si rezultat i këtij procesi mund të reduktohen mundësitë e replikimit dhe shpenzimet kontradiktore të mjeteve financiare që vijnë nga burime të ndryshme por kanë për qëllim adresimin e një sfide të caktuar. Kjo ndikon edhe në zbatim koherent të projekteve të buxhetuara në nivele të ndryshme të qeverisjes. Kjo, poashtu ofron mundësi për evaluim performance për institucione të caktuara, veprimtaria e të cilave shtrihet nën kornizën e një objektivave të caktuar.

Sa i përket inkorporimit të OZhQ-ve në proceset buxhetore kombëtare në nivel evropian, mund të themi që 23 vende deri tani janë zotuar për të filluar këtë proces, ose tashmë janë në një fazë të caktuar të këtij procesi. Megjithatë kampion i përfrimit të objektivave të vendit me OZhQ-të, njëkohësisht duke zbatuar deri tani në përqindje të lartë gati të gjithë OZhQ-të mbetet shteti i Finlandës. Finlanda ka integruar suksesshëm Agjendën 2030 si pjesë të planit të veprimtaria qeverisës, poashtu ka ndërlidhur këtë platformë me programet buxhetore duke alokuar kështu mjetet financiare drejtë objektivave të vendit të bashkërenduara me OZhQ-të.<sup>7</sup> Plani i Qeverisë së Finlandës për të zbatimin e Agjendës 2030 fokusohet kryesisht në dy tema: Një Finlandë neutrale ndaj karbonit dhe ruajtja e burimeve natyrore duke optimizuar përdorimin e tyre, dhe një Finlandë jo-diskriminuese dhe kompetente,<sup>8</sup> kështu duke fokusuar edhe mjetet financiare në këto fusha, por pa

---

<sup>7</sup> Hege Elisabeth, Brimont Laura (IDDRI), Integrating SDGs into national budgetary processes, 2018, Institut du développement durable et des relations internationales, i qasshëm në <https://www.pfmkin.org/sites/default/files/2020-02/175.%20Integrating%20SDGs%20in%20budgeting.pdf>

<sup>8</sup> Ministry of Finance; 'Budget Review 2019'; i qasshëm në <https://vm.fi/documents/10623/9929182/Budget+Review+2019/8bee9166-3849-4571-a099-aa1e57d65420?version=1.0>

lënë anash alokimin e mjeteve financiare për ministri përkatëse të cilat mbajnë përgjegjësi për objektiva të caktuara.

Si përfundim, inkorporimi i OZhQ-ve në buxhetim, si dhe duke përafruar ato me objektivat e synuara qeverisëse, mund të jetë e domosdoshme madje edhe kruciale për përmbushjen e OZhQ-ve të adaptuara në kontekst të vendit. Përfitimet janë të mëdha për vendet të cilat zotohen të zbatojnë Agjendën 2030 si dhe të buxhetojnë atë në nivel të përgjithshëm, duke filluar nga trajtimi i sfidave globale shoqërore, ekonomike, mjedisore dhe kulturore, por edhe për të përmbushur objektivat kombëtare përmes një platforme të tillë. E njëjta që do të mundësonte zbatimin e këtyre objektivave si dhe evidentimin e zbatimit, gjithmonë duke qenë në hap me trendet globale dhe duke përafruar kështu objektivat kombëtare me ato të vendeve më të zhvilluara në Evropë.

## **Modalitete të buxhetimit të OZhQ-ve në nivel lokal**

Objektivi i 16-të i Agjendës 2030 kërkon në veçanti fuqizimin e institucioneve, rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë si dhe gjithëpërfshirjen efektive në të gjitha nivelet. Në mënyrë që zbatimi i Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve të bëhet në mënyrë të njëtrajtshme, do të duhet të bëhet koordinimi dhe ndarja e përgjegjësisë në mes të akterëve relevantë si dhe të monitorohet dhe evidentohet zbatimi i saj, është kruciale që inkorporimi i OZhQ-ve të bëhet në nivel qendror. Megjithatë në mungesë të buxhetimit për OZhQ-të në nivel qendror, ka mënyra të operacionalizimit dhe buxhetimit të OZhQ-ve edhe në nivel lokal dhe duke filluar në autoritete lokale. Patjetër kjo ka ndodhur në disa qytete në botë, të cilat kanë konsideruar se është e nevojshme të veprojnë lokalisht në mënyrë që të punojnë drejtë zbatimit dhe përmbushjes së OZhQ-ve.

Një kornizë e tillë si korniza e OZhQ-ve mund të shërbejë në favor të autoriteteve lokale, ashtu siç shërben për institucionet e nivelit qendror. Kjo për faktin se Agjenda 2030 ka objektiva, qëllime dhe indikatorë të detajizuar mbi të cilën mund të drejtojnë punën edhe zyrtarët e administratës lokale, dhe madje të përfitojnë shumë. Përfitimet mund të jenë të mëdha, duke pasur parasysh se korniza për OZhQ-të konsiderohet dhe mund të adaptohet si një plan pune i detajizuar në shërbim të zyrtarëve administrative lokale. Në rastin e Kosovës komunat kanë për obligim përpilimin e një plani komunal të quajtur plan zhvillimor komunal (PZhK)<sup>9</sup>.

---

<sup>9</sup> Plani Zhvillimor Komunal (PZhK) është një nga instrumentet e planifikimit që është paraparë në Kosovë (Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 03/L-106). Ky është një plan multisektorial, i cili i përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror-social dhe hapësinor. Ky lloj sistemi i planifikimit bazohet në modele të planifikimit, të cilat tashmë janë aplikuar në vendet evropiane dhe më gjerë.

Në këtë rast përafrimi i objektivave lokale të paraqitura në PZhK me OZhQ-të, mund të ndihmonte strukturimin e punës së komunës në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe të ndihmonte në zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve. Poashtu, përpilimi i një strategjie për OZhQ-të të personalizuar duke u bazuar në sfidat që ka komuna si dhe integrimi i buxhetimit si objektivë specifike në strategji dhe në PZhK-të, do të konsiderohej hap tjetër tepër i nevojshëm për zbatimin e OZhQ-ve në tërësi, si dhe për adresimin e sfidave që secila komunë ka. Përveç kësaj, autoritet lokale do të duhej që në baza vullnetare të marrin vendim për përcaktimin e kornizës së OZHQ-ve si kriter fillestar për identifikimin e projekteve kapitale që do të futen në buxhet për investime. Marrë parasysh që globalisht qytetet dhe shtetet kanë vendosur të prioritojnë OZhQ-të në përputhje me objektivat lokale/kombëtare, kështu do të duhej të bënin edhe komunat, në mënyrë që të përmbushnin suksesshëm ato objektiva të cilat konsiderojnë më urgjente për t'u zbatuar.

Për të vazhduar me hapat konkretë që do të duhej të bënin autoritetet lokale në mënyrë që të zbatonin kornizën e OZhQ-ve, do të duhej patjetër ndërhyrje nga niveli qendror. Reforma në administratën publike, duke investuar në ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve administrativë është hap i domosdoshëm për të punuar drejtë përmbushjes së OZhQ-ve. Edhe pse kjo vazhdon të mbetet sfida shqetësuese në të gjithë globin, në Kosovë trajtimi i kësaj problematike është urgjente, për arsye të ndryshme. Megjithatë ngritja e kapaciteteve qeverisëse dhe vetëdijësimi i nëpunësve publikë për rolin e tyre aktiv në përmbushjen e OZhQ-ve, dhe në veçanti për të adoptuar tabelat e buxhetit në përputhje me indikatorët e OZhQ-ve, mbetet element me rëndësi në rrugën drejtë zhvillimit të qëndrueshëm.




Figura 2. Qeverisje e mirë për zbatimin e Agjendës 2030

Përveç rolit që do të mund të luanin autoritetet lokale për të përmbushur OZhQ-

të në baza vullnetare, kushtet fillestare do të duhej të krijoheshin nga institucionet dhe organet e nivelit qendror. Ministritë përkatëse si MFPT dhe MAPL në Kosovë, bashkë me organe të tjera të nivelit qendror, do të duhej të azhurnojnë format e buxhetit për komunat në mënyrë që objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të përfshihen, duke mundësuar kështu përfshirjen edhe në strategji buxhetore të komunave. Kjo do të mundësonte që zbatimi, investimi dhe monitorimi i OZhQ-ve të bëhej në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme.



## Përfundime dhe Rekomandime

Si përfundim, niveli i zbatimit të Agjendës 2030 dhe përmbushjes së OZhQ-ve në Kosovë nuk është i kënaqshëm. Edhe pse Kosova duke mos qenë anëtare e KB-ve nuk është e obliguar të zbatojë e as raportojë mbi zbatimin e saj në instanca të larta, Kosova do të duhej të përqafojë dhe trajtonte me seriozitet agjenda të tillë. Kjo për shkak të rëndësisë që bartin për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm në vend, si dhe për t'u përgatitur për integrim në bashkësitë ndërkombëtare.

Gjithsesi, për të prioritzuar dhe thelluar zbatimin e Agjendës 2030, duhet ndërmarrë hapa konkretë në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes. Megjithëse globalisht trupat koordinues që punojnë brenda kuadrit të pushtetit ekzekutiv, korrin më shumë sukses dhe arrijnë të zbatojnë OZhQ-të në nivel më të lartë, në Kosovë, trupi koordinues i OZhQ-ve, KZhQ-ja është në kuadër të pushtetit legjislativ, i cili i atribuohet Kuvendit. Por, pavarësisht kësaj ligjvënësit si dhe Qeveria, duhet të marrin parasysh këtë kornizë të rëndësishme si dhe të inkorporojnë OZhQ-të në çdo strategji pune, për të adresuar sfidat në vend, si dhe për të përafuar objektivat kombëtare me objektiva globale, duke mundësuar kështu edhe ndjekjen e trendeve globale në raport me politikbërjen.

Sa i përket mundësive për të prioritzuar agjendën 2030, inkorporimi i OZhQ-ve në kornizat buxhetore, mundëson edhe përafrimin e këtyre objektivave me objektivat e synuara të Qeverisë. Kështu duke ndikuar në strukturimin e punës si dhe eliminimin e përsëritjeve të alokimeve të mjeteve financiare nga burime të ndryshme, për një qëllim të caktuar. Rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë koherente projekte që adresojnë sfida të njëjta, dhe duke monitoruar Agjendën 2030. Jetike për një zbatim të duhur të kësaj agjende është edhe adaptimi i OZhQ-ve në kontekst vendor, e cila poashtu eliminon mundësitë për zbatim jo të duhur të Agjendës 2030 dhe rrit efektivitetin e punës së institucioneve dhe organeve përgjegjëse për rezultate në këtë drejtim. Përtej kësaj, më poshtë gjeni të renditura rekomandimet për buxhetimin me OZhQ në institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë:

*Përcaktimi i qartë i targeteve komunale të bazuara në kornizën e OZHQ-ve* – është element kyç në përfshirjen e OZHQ-ve në nivel komunal. Kjo mund të bëhet duke harmonizuar kornizën e funksionimit të komunës me atë të OZHQ-ve, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) tek Planet sektoriale si Plani Komunal i Arsimit, i shëndetësisë etj. Të gjitha këto duhen ndërlidhë me objektiva të qarta dhe instrumente matëse të progresit siç janë planet e veprimit për zbatim lokal të OZHQ-ve, raporet e zbatimit të projekteve kapitale me OZHQ etj.

*Azhurnimi i formave të buxhetit nga institucionet e nivelit qendror* është element crucial për avancimin e OZhQ-ve dhe Agjendës 2030. Ministria e Pushtetit Lokal

në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet e nivelit qendror në përgjithësi duhet të azhurnojnë format e buxhetit për komunat në mënyrë që objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të përfshihen dhe investimi në OZhQ të përcillet në mënyrë të qëndrueshme. Vendosja e angazhimit për OZhQ-të si kriter nga ana e MPL-së për përfitim të Grantit të Performancave do të mundësonte angazhim më të madh dhe trajtim me seriozitet edhe nga ana e komunave në raport me Agjendën 2030.

*Ngritja e kapaciteteve të komunave* përmes iniciativave të ndërmarra nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës. Kjo duhet bërë fillimisht duke hartuar një kurrikulë në bashkëpunim me ekspertë mbi qeverisjen me OZhQ-të në nivelin e institucioneve lokale. Pastaj duke adoptuar tabelat e buxhetit në përputhje me indikatorët e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Adaptimi dhe strukturimi i punës në bashkërendim me OZhQ-të do të ju mundësonte komunave përveç zbatimit të OZhQ-ve edhe monitorimin e zbatimit të tyre, duke eliminuar njëkohësisht përsëritjet e alokimit të mjeteve financiare nga burime të ndryshme për një qëllim të caktuar.

*Përfshirja e OZhQ-ve në strategji dhe plane zhvillimore* të autoriteteve të nivelit lokal është gjithashtu synim që do të duhej të merrej parasysh nga të gjitha komunat, e në veçanti nga komunat të cilat kanë avancuar në raport me zbatimin e Agjendës 2030, si komuna e Drenasit. Përfshirja dhe ndërlidhja e OZhQ-ve me objektiva të Planit Zhvillimor Komunal do të mundësonte zbatim të strukturuar dhe të dukshëm të Agjendës 2030 në institucionet e nivelit lokal. Në kuadër të kësaj komunat do të duhej të merrnin si bazë dhe referencë fillestare kornizën e OZhQ-ve për identifikimin e projekteve kapitale që integrohen në sektorin e investimeve kapitale në planifikim buxhetor.

*Instrumenti për Monitorimin e buxhetimit me OZhQ-të*, do të mund të përgatitej nga komunat në bashkëpunim me organizatat lokale të shoqërisë civile dhe donatorët ndërkombëtarë. Kjo matricë e vlerësimit do të ndërlidhej me objektivat në PZhK-të e komunave, projektet kapitale të përfshira në buxhet, si dhe do të shërbente si mjet për matjen e progresit, vlerësimin e performancës së komunës dhe planifikimet për buxhetet e ardhshme.

*Hartimi i Raportit Vullnetar të Vlerësimit për OZhQ-të* është mjet monitorues shumë i rëndësishëm për të matur zbatimin e OZhQ-ve në nivel lokal. Kjo për faktin se VLR-të mundësojnë që komunat të identifikojnë prioritetet e tyre dhe specifikat territorial që ato kanë. VLR-ëtë përveç që konsiderohen plan i ardhshëm zhvillimor për autoritetin lokal, të dhënat me të cilat punohen mundësojnë analizë të thukët të gjendjes aktuale, duke ndikuar kështu edhe në hartim të politikave, të bazuara në të dhëna reale. Për më tepër hartimi i VLR-së përfshin shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit, të cilët janë partnerë të nevojshëm për të përkthyer objektivat në zgjidhje konkrete për të gjithë. Sa i përket Komunës së Drenasit që

tashmë ka në funksionalizim Platformën për monitorimin e OZhQ-ve<sup>10</sup>, të dhënat e dala nga kjo platformë mund të përdoren edhe në procesin e planifikimit buxhetor.









Është e dukshme që Agjenda 2030 është tejet kërkuese dhe pretendimi për të arritur caqet e vendosura ndërkombtarisht, sidomos për një vend si Kosova është tepër ambicioz. Për këtë arsye Kosova duhet të prioritetizojë objektiva të caktuara dhe të vendosë caqe konkrete për zbatimin e tyre. Kështu, Kosova do të duhej të përfronte Strategjinë për Zhvillim Kombëtar me strategjitë e tjera zhvillimore në mënyrë që të punohet drejtë avancimit të kësaj strategjie me hapa konkretë dhe të sigurtë. Strategjinë do të duhej ta pasonin plane konkrete të veprimit në nivel qendror dhe lokal, në mënyrë që të operacionalizohen edhe objektivat e vendosur, dhe të evidentohet zbatimi duke ndikuar kështu edhe në zbatim koherent të projekteve të cilat buxhetohen në nivele të ndryshme qeverisëse, në këtë drejtim.








---


<sup>10</sup>Platforma e OZhQ-ve për Drenas, është një mjet monitorues dhe matës kundrejt mirëqenies së komunës së Drenasit. Platforma raporton mbi 17 OZhQ-të dhe indikatorët përkatës. E qasshme këtu: <https://drenas.tracking-progress.org/>

## Shtojca A – Integrimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në planet buxhetore komunale

Programet	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Totali	OZhq Përkatëse
Zyra e Kryetarit	157,740	53,485		8,000		219,225	
Administrata Përgjithshme	236,037	149,444			44,000	429,481	
Drejtoria Inspektionit	68,581	52,650				121,231	
Zyra e Kuvendit Komunal	109,927	44,150				154,077	
Drejtoria për Buxhet dhe financa	103,889	18,000				121,889	
Drejtoria e Shërbimeve Publike	164,126	292,269	165,500	90,000	223,000	934,895	  
Drejtoria e Infrastrukturës publike	49,758	26,800			4,254,095	4,330,653	
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	7,996	680				8,676	
Drejtoria e Bujqësisë	76,192	12,329		60,000		148,521	 
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	48,985	26,250		32,000		107,235	
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	84,150	10,150				94,300	
Drejtoria e Urbanizmit	48,037	17,517			50,000	115,554	
Drejtoria Ad. Shend	36,562	52,340		25,000		113,902	
Qendra për Punë Sociale	91,961	42,680	9,200			143,841	
Drejtoria për Kulturë dhe Rini	75,295	122,175		125,000	545,000	867,470	

<b>Administrata e Arsimit</b>	77,139	230,000		80,000	405,000	792,139	
<b>Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare</b>	1,476,351	587,445	54,000		520,000	2,637,796	
<b>Arsimi parafillosor</b>	178,053	47,482	6,549			232,084	
<b>Arsimi fillor</b>	4,628,133	424,175	65,000			5,117,308	
<b>Arsimi i mesëm</b>	1,319,142	125,472	22,000			1,466,614	
<b>Totali</b>	<b>9,038,054</b>	<b>2,335,493</b>	<b>322,249</b>	<b>420,000</b>	<b>6,041,095</b>	<b>18,156,891</b>	
<b>Projektet kapitale</b>							
<b>Programi</b>	<b>Emri i projektit</b>				<b>Totali</b>	<b>OZhQ Përkatëse</b>	
<b>Administrata dhe personeli</b>	1. Paisje tjera mbi 1000€				44,000		
<b>Infrastrukturë rrugore</b>	1. Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbra dhe rregullimi i sheshit				23,000		
	2. Sinjalizimi vertikal dhe horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve				40,000		
	3. Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit				50,000		
	4. Rregullimi i sistemit të ujitjes për parkun e qytetit me gypa nëntokësor ku ujitja bëhet me sistem automatik				50,000		
	5. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në Komunë				5,000		
	6. Rregullimi dhe mirëmbajtja e trotuareve dhe parkingjeve				5,000		
	7. Instalimi i ndriqimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues				30,000		
	8. Rregullimi dhe rehabilitimi tregjeve				5,000		
	9. Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre				10,000		
	10. Bashkëfinancim projektsh				5,000		
<b>Infrastrukturë publike</b>	1. Rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Verbica				30,000		
	2. Asfaltimi i rrugës Llapushnik - Berishë				70,000		
	3. Ndërtimi i rrugës bregut Qyqavicës				70,000		
	4. Ndërtimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biciklist në parkun e Kamenicës - Komuna e Drenasit				250,000		
	5. Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunë				350,000		
	6. Rregullimi i infrastrukturës së trotuareve dhe ndriqimi publik në Komunë				250,000		
	7. Ndërtimi i infrastrukturës (asfaltimi dhe kubzimi) Drenas I, II, III dhe IV				320,000		
	8. Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci"				505,446		
	9. Infrastruktura në Komoran I, II, III dhe IV				100,000		
	10. Ndërtimi i tumbinave dhe mureve mbrojtëse				120,000		
	11. Rehabilitimi dhe rekonstruktimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Drenasit				443,649		
	12. Rehabilitimi dhe rekonstruktimi i rrjeteve të kanalizimeve në Komunën e Drenasit				350,000		
	13. Asfaltimi i rrugës Gllanasellë Godanc				70,000		
	14. Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I, II dhe Gllobar				70,000		
	15. Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë				70,000		
	16. Infrastruktura në fshatin Abri Epërme, Terdevc				70,000		
	17. Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec Qikatovë e Vjetër				70,000		
							
							

	18. Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek, Shtrubullova	70,000	
	19. Ndërtimi i infrastrukturës Nekoc Kizharekë	70,000	
	20. Asfaltimi i rrugës Gredicë - Likoshan	70,000	
	21. Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq	70,000	
	22. Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët	70,000	
	23. Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtutic, Verbovc, Polluzh	70,000	
	24. Asfaltimi i rrugës në Llapushnik, Poterk, Vukovc	70,000	
	25. Asfaltimi i rrugës Zebel i Ulët dhe Epërm, Korroticë e Ulët dhe Epërme	70,000	
	26. Ndërtimi i kapacitetit të ujit në Komunën e Drenasit	270,000	
	27. Bashkëfinancim i projekteve me donator të jashtëm	50,000	
	28. Hapja e kanaleve kulluese përgjatë rrugëve në Komunë	25,000	
	29. Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferik në Drenasin I, II, III dhe IV	10,000	
	30. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Komoran I, II, III dhe IV	10,000	
	31. Kanalizimi i ujërave të zeza Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq	10,000	
	32. Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët	10,000	
	33. Kanalizimi i ujërave të zeza Terstenik I dhe II Gillobar	10,000	
	34. Kanalizimi i ujërave të zeza Korroticë e Ulët dhe Korroticë e Epërme, Poklek i Vjetër dhe i Ri	10,000	
	35. Kanalizimi i ujërave të zeza të fshatit Dobroshec, Qikatovë e Vjetër	10,000	
	36. Kanalizimi i ujërave të zeza Abri e Epërme, Terdec	10,000	
	37. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Gllanasellë, Godanc	10,000	
	38. Kanalizimi i ujërave të zeza Gradicë, Likoshan	10,000	
	39. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Llapushnik, Poterk dhe Vukovc	10,000	
	40. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Kishanarekë	10,000	
	41. Kanalizimi i ujërave të zeza Shtutic, Verbovc dhe Polluzhë	10,000	
	42. Kanalizimi i ujërave të zeza Baicë, Krajkovë dhe Damanek, Shtrubullova	10,000	
<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>	1. Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishe	25,000	
	2. Mirëmbajtja e sistemit të adresave, vendosja e tabelave dhe numrave në teren	5,000	
	3. Gjelbërimi i hapësirave publike	20,000	
<b>Shëndetësia dhe mirëqenia sociale</b>	1. Rrethoja e QMF, AMF	20,000	
	2. Inventari QKMF, QMF AMF	5,000	
	3. Instalimi i nxemjeve nëpër QMF dhe AMF	70,000	
	4. Pjerrinat nëpër AMF	10,000	
	5. Paisje speciale mjeksore mbi 1000€	300,000	
	6. Vetura të ndihmës së shpejtë, dy vetura me paisje	70,000	
	7. Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit SHKPAK		
	8. Zgjerimi QMF Arllat	45,000	
<b>Kulturë, rini dhe sport</b>	1. Renovimi i objekteve sportive	20,000	
	2. Ndërtimi i stadionit faza e dytë	100,000	
	3. Inventarizimi i arkivit dhe Qendrës së Kulturës	10,000	
	4. Fusha sportive dhe rekreacion	115,000	
	5. Shtëpi e kulturës, Muze, Arkivë, Bibliotekë, Teatër (Galeri e arteve) Terstenik, Komoran	300,000	
<b>Arsim dhe shkencë</b>	1. Digjitalizimi i shkollave (platforma për digjitalizim dhe rrjet i mbrendshëm interneti)	60,000	
	2. Inventarizimi i shkollave në Drenas	43,000	
	3. Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut	60,000	

	4. Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse dhe furnizimi me pajisje për kabinet kimi, fizikë dhe biologji	50,000	
	5. Ndërtimi i parkingjeve të shkollave dhe pllatove	30,000	
	6. Ndërtimi i fushave të jashtme sportive dhe rrethojave të fushave	30,000	
	7. Këndi për lojra dhe rekreacion	40,000	
	8. Renovimi i shkollave objekteve shkollore, nyje sanitare dhe ngjyrosje dhe suvatim	78,000	
	9. Riparimi i nxemjeve qëndrore	14,000	
<b>Totali</b>		<b>6,041,095</b>	

## Shtojca B – Analiza e buxhetimit të OZhQ-ve

OZhQ-të si pjesë e Agjendës 2030 janë një set i objektivave gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme. Buxheti publik është një mjet ekonomik dhe politik tejet i fuqishëm që siguron implementimin e politikave, planeve dhe prioriteteve të vendit. Sa më i mirë të jetë buxheti publik, aq më afër planeve janë zbatimi dhe rezultatet e politikave.<sup>11</sup> Andaj ndarja e buxhetit komunal për përmbushjen e targeteve të OZhQ-ve luan rol dhe ka rëndësi të veçantë në zbatimin e Agjendës 2030.

Buxheti i komunës së Drenasit për vitin 2023 është 18,156,891.00€. Ndarja buxhetore bëhet në Paga dhe Shtesa, Mallërat dhe Shërbimet, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe Transferet, Shpenzimet Kapitale dhe Rezervat. Në komunën e Drenasit është analizuar e gjithë kjo ndarje buxhetore duke përfshirë gjithashtu edhe projektet kapitale. Nga analiza e buxhetit të komunës vërehet se në Drenas 11 nga 17 OZhQ janë të përfshira në shpenzime buxhetore.

Shpenzimet e lidhura me zyrën e kryetarit, administratën e përgjithshme, drejtorinë e inspeksionit dhe zyrën e kuvendit komunal ndërlidhen me targetet e objektivës 16, “Paqe, drejtësi dhe institucione stabile”. Buxheti i ndarë për arsimin qartësisht ndërlidhet me objektivën 4 për arsim cilësor. Ndërsa OZhQ 1 “Pa varfëri” dhe OZhQ 3 “Shëndet i mirë dhe mirëqenie” preken nga buxheti i ndarë për QKMF, QPS, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe Drejtoria e Administrimit të Shëndetësisë. Puna e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ndërlidhet me targetet e objektivës së 8 “Punë e dinjitetshme dhe rritje ekonomike”, kurse Drejtoria për Kulturë dhe Rini dhe Drejtoria e Urbanizimit me targetet e objektivës 11 për qytete të qëndrueshme. Përfundimisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Infrastrukturës publike dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim përfshijnë targete të caktuara të objektivave 1, 9 “Industri, inovacion dhe infrastrukturë”, 10 “Zvogëlim i pabarazive” dhe 11.

Në anën tjetër, komuna për vitin 2023 ka planifikuar buxhet edhe për projekte kapitale. Projektet në fushën e administratës hyjnë në synimet e objektivës 16. Infrastruktura rrugore dhe ajo publike ka projekte të planifikuara, me implementimin e të cilave preken targete të objektivave 6 “Ujë i pastër dhe higjienë”, 9 dhe 11. Poashtu projektet e fushës së planifikimit urban dhe mjedisit janë në vijë me targetet e objektivës 11. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale kanë projekte të planifikuara që ndërlidhen me OZhQ 1 dhe 3, ndërsa projekte për kulturë, rini dhe sport janë investime në objektivën e 9 dhe 11. Implementimi i

---

<sup>11</sup> Budgeting for the Sustainable Development Goals, UNDP, e qasshme në [https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook\\_Nov%202020.pdf](https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf)



projekteve për arsim dhe shkencë do të sjellë progres në targetet e objektivës 4 dhe 9.

Komuna e Drenasit në aspektin e ndarjes buxhetore ka një rrugë të gjatë përpara. Në vitin 2023 komuna ka bërë një ndarje të mirë buxhetore, por jo progresive. Në vitet në vazhdim komuna duhet të ketë parasysh ndarjen e buxhetit në mënyrë që të arrij qëllimet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë më specifike. Gjithashtu duhet të punohet në përfshirjen e objektivave që nuk janë të përfshira në ndarjen buxhetore.

Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH  
në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

